




Pranuar / Dorezuar Prilimjen / Predato Received / Delivery	19-04	2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOMSHCK	1884/2021		114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.169/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.1140/20 të datës 12.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 18.03.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.139/2020 të datës 30.04.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr."Agim Zajmi", Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.139/2020 e datës 30.04.2020, e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi i emëruar sipas Akt emërimit të datës 03.04.2013 në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 01.04.2016 i është vazhduar mandati edhe për tri vite nga data 01.04.2016 deri me datë 01.04.2019 sipas Vendimit me Nr.04/194 të datës 23.07.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa sipas Vendimit me numër Nr.280/2019 të datës 12.04.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i është vazhduar mandati edhe për 9 (nëntë) muaj nga data 12.04.2019 deri me datë 31.12.2019.

Zyra e Personelit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në muajin nëntor të vitit 2019 e ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve lidhur me ofrimin e përfundimit të mandatit të "Kryeshefit Ekzekutiv", në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i vazhduar sipas Vendimit të datës 12.04.2019 për periudhën 9 mujore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 24.12.2019 ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për periudhën 12 prill 2019 deri me 31.12.2019.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me datë 08.01.2020 përmes e-mailit zyrtar e ka njoftuar ankuesin se „kontrata e juaj ka skaduar me datën 31.12.2019, si rrjedhojë ju nuk jeni

Kryeshef i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nuk jeni kompetent të merrni asnjë vendim për SKQZ-në dhe ka kërkuar nga ankuesi që ta liroje zyrën, ndërsa me datë 15.01.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nxjerrë Vendimin me numër Nr.40/2020 me të cilin Drejtorin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim e cakton Ushtrues të Detyrës së "Kryeshefit Ekzekutiv", në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ankuesi i pakënaqur me ndërprerjen e mandatit me datë 06.02.2020 parashtron ankesë me numër protokollit 106-2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 05.03.2020 nxjerrë Vendim me numër protokollit 318/2020, me të cilin e shtynë afatin e vendim marrjes për procedurën administrative, ndërsa me datë 06.04.2020 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nxjerrë Vendim me numër Nr.435/2020, me të cilin e bart ankesën e ankuesit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të konfliktit të mundshëm të interesit.

Ankuesi me datën 30.04.2020, parashtron ankesë me numër të protokollit 794/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që të rikthehet në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mandatin e rregullt ligjor dhe të anuloj Vendimin për caktimin e Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.04.2020 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa me datën 09.06.2020 Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka përcjell në Këshill dokumentacionin me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 18.06.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 12.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1140/20 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 18.06.2020 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 30.04.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimi A.nr.1140/2020 i datës 12.03.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi datës 18.06.2020; Kërkesë e përsëritur e datës 18.06.2020 për mes E-mailit; Njoftim elektronik i datës 24.06.2020 (e-mail); Ankesa me numër protokollit 794/2020 e datës 30.04.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes E-mail të datës 30.04.2020; Ankesa e datës 06.02.2020 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Formulari i vlerësimit të



kryerjes së punës për 2019, i datës 24.12.2019, nga data 01.04.2019 deri me datës 31.12.2019; Raport i datës 24.12.2019; Vendimi NR.318/2020 i datës 05.03.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi i datës 15.01.2020 për ushtruesin në detyrë me nr.40/2020; Vendimi i datës 06.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Aktgjykimi i datës 20.07.2012 rastet K.O.29/12dhe K.O.48/12; Përgjigje në ankesë e datës 09.06.2020; E-mail i datës 07.05.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 06.05.2020; Vendimi me numër Nr.280/2019, i datës 12.04.2019 i Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Vendimi nr. 267/2016 i datës 01.04.2016; Akte emërimi i datës 02.04.2013 të protokolluar me numër 259-2013; E-mailit zyrtar i datës 11.04.2019 i Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 06.04.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; E-mail i datës 26.12.2019; E-mailit zyrtar i datës 08.01.2020; E-mailit zyrtar i datës 10.01.2020; E-mail i datës 04.03.2020; Takimi i datës 11.02.2020; Takimi i datës 05.03.2020.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është emëruar sipas Akt emërimit të datës 03.04.2013 në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me mandat tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi. Sipas Vendimit me Nr.04/194 të datës 23.07.2014 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 01.04.2016 ankuesit i është vazhduar mandati edhe tri (3) vite tjera nga data 01.04.2016 deri me datë 01.04.2019 në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Emërimi i ankuesit në pozitën e „Kryeshefit Ekzekutiv“ në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është bërë sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi nuk i ka pasur vlerësimet e rezultateve të punës të plota, gjatë mandatit të tij të dytë në pozitën „Kryeshef Ekzekutiv“ konkretisht vlerësimin e rezultateve të punës për vitin mars 2018-mars 2019 sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka qenë funksional, gjegjësisht anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë emëruar me datë 28 mars 2019. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar sqarime lidhur me këtë çështje nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili në përgjigjen e datës 11.04.2019 ka theksuar decidivisht se „Këshilli vlerëson se Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv ka përfunduar, vlerësimet e punës se tij nuk janë të plota dhe kjo përbërje si e tille nuk mund ta vlerësoj për vitin 2018, prandaj rrjedhimisht Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është i obliguar që në mbledhje të KQZ-së të nxjerr vendim për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv në KQZ ose vazhdimin e mandatit në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil“ .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.04.2020, pasi ka shqyrtuar çështjen e vazhdimin të mandatit të Kryeshefit Ekzekutiv ka nxjerr Vendim me numër Nr.280/2019 të datës 12.04.2020, me të cilin vendim ankuesit i është vazhduar mandati vetëm për 9 (nëntë) muaj, nga data 12.04.2019 deri me datë 31.12.2019, rrjedhimisht nuk ka pasur vazhdim për një mandat tjetër tre (3) vjeçar ashtu siç parashihet me legjislacionin e shërbimit civil respektivisht me nenin 22 të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Andaj, Kolegji konstaton se ky ka qenë momenti kur ankuesit i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 12.04.2020 ka nxjerr Vendim me numër Nr.280/2019 me të cilin ankuesit i ka vazhduar mandatin vetëm për 9 (nëntë) muaj, ndërsa ankuesi ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datë 30.04.2020, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: **1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ**” si dhe po ashtu në kundërshtim me afatin e përcaktuar me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ku është përcaktuar se: **„Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”**.

Mbi këtë bazë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se momenti kur ankuesit ka filluar të rrjedh afati për ankimim ka qenë nga data 12.04.2019 kur ankuesi e ka pranuar Vendimin me numër Nr.280/2019 të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve me të cilin vendim i është vazhduar mandati vetëm për 9 muaj, e që rezulton se ankuesi nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike brenda afatit të përcaktuar ligjor, sipas dispozitave të lartë cekura.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe gjatë shqyrtimit të bazës ligjore, në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.169/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Proçesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative
- Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
- Udhëheqësit të Personelit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së .